



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1573/7 prot.

Datë 11.07.2025

V E N D I M

Nr. 892/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.07.2025, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr.REF-50068-06-03-2025, me objekt: “*Blerje bojë për sinjalistikë rrugore*”, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK me NUIS M07214203A dhe adresë: Skrofotine, Rruga Nacionale Vlore-Fier, Godina e Vellezerve Agalliu, Godina Nr.1, Vlorë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Rruga “5 Maji”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”; Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dy ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.06.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *“E hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr.REF-50068-06-03-2025, me objekt: *“Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”*, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

II.2. Në datën 18.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5435, protokolluar me nr. 1573/2025 prot, datë 18.06.2025 e operatorit ekonomik *“Vëllezërit Agalliu 20” SHPK*, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit *“E hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr.REF-50068-06-03-2025, me objekt: *“Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”*, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

II.2.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3. Në datën 20.06.2025 përsëri nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5444, protokolluar me nr. 1594/2025 prot, datë 20.06.2025 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, me anë të së cilave kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 03.07.2025, nëpërmjet shkresës nr. 1573/1 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK*”, duke qënë se nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe me qëllim vijimin e gjyqimin e ankesave pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta dhe për kualifikim e specifikimeve teknike, vendimet e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesave të operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK si dhe veprimet proceduriale të kryera nga ana e autoritetit kontraktor sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për plotësimin e të metave të ankesave, lidhur me pagesën e tafifës së ankimit.

II.5. Në datën 07.07.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1594/1 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2531/4 prot., datë 04.07.2025 me objekt: *“Kthim përgjigje”*, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në datën 18.06.2025 Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20 ” sh.p.k ka ngarkuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik ankesë/kërkesë lidhur me nje nga kriteret e përcaktuara ne DST-në e proçedurës së prokurimit me objekt “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore” me Nr. REF-50068-06-03-2025 lidhur me kërkesën për dorëzimin fizik të mostrave për të gjithë artikujt në ditën e hapjes së ofertave.

Personi përgjegjës per proçedurën në datën 19.06.2025 ka kthyer pergjigje ne Sistemin e Prokurimit Elektronik duke dhënë argumentat përkatëse dhe duke mos e marrë në konsideratë ankesë/kërkesën e operatorit ekonomikë.

Në datën 20.06.2025 Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20 ” sh.p.k ka dërguar sërish ne Sistemin e Prokurimit Elektronik kundërgargument/vërejtje lidhur me kthimin e përgjigjes nga ana e personit Pergjegjes duke parashtruar arsyetimin e tij ligjor.

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, gjatë kësaj kohe, janë informuar nëpërmjet faqes ëëë.kpp.al se Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” sh.p.k ka plotësuar formularin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por është konstatuar se bashkëlidhur ankimit mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Në këtë moment anëtari i Njesisë së prokurimit i ka dërguar Operatorit Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” sh.p.k në SPE, në datën 24.06.2025, bazuar në Ligjin Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) Neni 111, Paraqitja e ankesës pika 3 “Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”, kërkesë sipas nenit të sipërpërmendur.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se për shkak të problemeve teknike të dokumentuara të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka qënë e pamundur tju vinin në dijeni vendimin e marrë Komisionit të Prokurimit Publik shoqëruar me shpjegimet përkatëse.”

II.6. Në përgjigje të kërkesës me nr. 1573/2 prot., datë 07.07.2025 për verifikim pagese, lidhur me ankesën e lartpërmendura, drejtuar Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, këtu, nga ky Komision, me shkresën nr. 1573/4 prot., datë 09.07.2025 Komisioni i Prokurimit Publik u bë me dije se për ankesën me nr. 1573/2025 prot, datë 18.06.2025 me numër ankimi elektronik nr. A/2025/5435 dhe ankesën nr. 1594/2025 prot, datë 20.06.2025 me numër ankimi elektronik me nr. A/2025/5444, nga ana e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, nuk është paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifat e ankimimit. Për më tepër, referuar raportit të dërguar më datë 09.07.2025 nga Dega e Thesarit për arketimet e kryera për muajin Qershor – Korrik 2025, rezulton se operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesat e sipërcituara.

II.7. Me shkresën me nr. 1573/3 prot., datë 08.07.2025 me objekt: “Kërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK informacion nëse është vënë në dijeni apo jo nga ana e autoritetit kontraktor për plotësimin e të metave të ankesave, sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në rast se nuk është vënë në dijeni të mangësve në fjalë, brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi ankimuesit korigjimin e të metave të ankesave, sipas parashikimeve të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë iu komunikua operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK edhe nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

Aktualisht nga ana e ankimuesit nuk është kthyer përgjigje dhe nuk është kryer asnjë pagesë për ankesat e sipërcituara.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Nga shqyrtimi i ankesave së operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.3. Në datën 18.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5435, protokolluar me nr. 1573/2025 prot, datë 18.06.2025 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50068-06-03-2025, me objekt: “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar

me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

III.1.3.1 Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.4. Në datën 20.06.2025 përsëri nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5444, protokolluar me nr. 1594/2025 prot, datë 20.06.2025 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, me anë të së cilave kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.4.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.5. Në datën 03.07.2025, nëpërmjet shkresës nr. 1573/1 prot., me objekt: “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK*”, duke qënë se nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe me qëllim vijimin e gjyqimin e ankesave pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta dhe për kualifikim e specifikimeve teknike, vendimet e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesave të operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana e autoritetit kontraktor sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për plotësimin e të metave të ankesave, lidhur me pagesën e tafifës së ankimit.

III.1.6. Në datën 07.07.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1594/1 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2531/4 prot., datë 04.07.2025 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në datën 18.06.2025 Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20 ” sh.p.k ka ngarkuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik ankesë/kërkesë lidhur me nje nga kriteret e përcaktuara ne DST-në e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore” me Nr. REF-50068-06-03-2025 lidhur me kërkesën për dorëzimin fizik të mostrave për të gjithë artikujt në ditën e hapjes së ofertave. Personi përgjegjës per procedurën në datën 19.06.2025 ka kthyer pergjigje ne Sistemin e Prokurimit Elektronik duke dhënë argumentat përkatëse dhe duke mos e marrë në konsideratë ankesë/kërkesën e operatorit ekonomikë. Në datën 20.06.2025 Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20 ” sh.p.k ka dërguar sërish ne Sistemin e Prokurimit Elektronik kundërargument/vërejtje lidhur me kthimin e përgjigjes nga ana e personit

Pergjegjes duke parashtruar arsyetimin e tij ligjor. Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, gjatë kësaj kohe, janë informuar nëpërmjet faqes ëëë.kpp.al se Operatori Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” sh.p.k ka plotësuar formularin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por është konstatuar se bashkëlidhur ankimit mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Në këtë moment anëtari i Njesisë së prokurimit i ka dërguar Operatorit Ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” sh.p.k në SPE, në datën 24.06.2025, bazuar në Ligjin Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) Neni 111, Paraqitja e ankesës pika 3 “Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur” , kërkesë sipas nenit të sipërpërmendur. Gjithashtu ju bëjmë me dije se për shkak të problemeve teknike të dokumentuara të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka qënë e pamundur tju vinin në dijeni vendimin e marrë Komisionit të Prokurimit Publik shoqëruar me shpjegimet përkatëse.”

III.1.7. Në përgjigje të kërkesës me nr. 1573/2 prot., datë 07.07.2025 për verifikim pagese, lidhur me ankesat e lartpërmendura, drejtuar Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, pranë KPP-së, me shkresën nr. 1573/4 prot., datë 09.07.2025 Komisioni i Prokurimit Publik u bë me dije nga ky sektor se, për ankesën me nr. 1573/2025 prot, datë 18.06.2025 me numër ankimi elektronik nr. A/2025/5435 dhe ankesën nr. 1594/2025 prot, datë 20.06.2025 me numër ankimi elektronik me nr. A/2025/5444, nga ana e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, nuk është paraqitur dokument bankar që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifat e ankimimit. Për më tepër, sqarohet se, referuar raportit të dërguar më datë 09.07.2025 nga Dega e Thesarit për arketimet e kryera për muajin Qershor – Korrik 2025, rezulton se operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesat e sipërcituara.

III.1.8. Duke qënë se nga shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2531/4 prot., datë 04.07.2025 me objekt: “Kthim përgjigje”, nuk jepet informacion i saktë dhe i qartë, vërtetuar me dokumentacion, mbi veprimet e ndërmarra nga ana e tij si dhe përgjigjet e mundshme të ankimuesit për plotësimin e të metave të ankesave të tij, nëpërmjet shkresës me nr. 1573/3 prot., datë 08.07.2025 me objekt: “Kërkesë”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK informacion nëse është vënë në dijeni apo jo nga ana e autoritetit kontraktor për plotësimin e të metave të ankesave, sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në rast se nuk është vënë në dijeni të mangësve në fjalë, brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi ankimuesit korigjimin e të metave të ankesave, sipas parashikimeve të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë iu komunikua operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK edhe nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

Aktualisht nga ana e ankimuesit nuk i është kthyer përgjigje KPP-së dhe nuk është kryer asnjë pagesë për ankesat e sipërcituara.

III.1.9. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në kushtet kur ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesave, edhe pas njoftimit të bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik, si më sipër cituar, ky Komision gjykon, se ankesat e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, nuk plotësojnë një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në germën “a” të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, këto ankesa duhen refuzuar.

III.1.10. Gjithashtu konstatohet se, në datën 04.06.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-50068-06-03-2025, me objekt: “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe në datat 18.06.2025 dhe 20.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë administruar me nr. 1573/2025 prot, dhe nr.1594/2025 prot.

III.1.10.1. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.10.2. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.10.3. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.10.4. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.1.10.5. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

III.1.10.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit *mbi kufirin e lartë monetar*, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është *brenda 10 ditëve* nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës (04.06.2025), ka qenë data 13.06.2025. Në këtë kuadër, ankesat pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik janë paraqitur përkatësisht në datë 18.06.2025 dhe 20.06.2025, pra jashtë afateve të ankimimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 13.06.2025, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon, se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës 04.06.2025 dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është 04.06.2025, ndërkohë ankesat e paraqitura nga ankimuesi në sistemin e ankesave elektronike të KPP-së, janë bërë në datat 18.06.2025 dhe 20.06.2025, jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesave nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023

“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK me nr. 1573/2025 prot, datë 18.06.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-50068-06-03-2025, me objekt: “Blerje bojë për sinjalistikë rrugore”, me fond limit 57,499,603.33 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK me nr.1594/2025 prot, datë 20.06.2025 për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

